

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria shtrin modelin Kayo tek rezerva e naftës, biznes 300 milionë euro në vit pa tender
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/qeveria-shtrin-modelin-kayo-tek-rezerva-e-naftes-biznes-300-milione-e-i104637
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:13:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:04:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e68411748bf9077b3f926c3bd15688e4a97bac393d4a1520f55e843bc4c5d018
TEKSTI	ac8c905048121c5bdd2548ceb2b0210ffa1bca42971c46cf9953a5468f704957
PAMJA	36b259b4dd811ec383c98ff8ecd35ae690e2136351f22588e06ef61ab425956c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f31093d88f25f518f4c090ea3a2ea983c66a770e236afbba70f5ae42b6e4ce81
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f31093d88f25f518f4c090ea3a2ea983c66a770e236afbba70f5ae42b6e4ce81>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

Greqil!
Dyshohet dhe nuk është kthyer më në

mbrojtjen e Evropës. A
do ta bëjë amerikanët të ndihen si në

pas tubimit
të së hënës protestës së zhvilluar të hënën në Tiranë

minj do ju
marrë me
vete në drejtua socialsitëve duke i thënë

Shoqerohet
në polici
edhe 'diali' i ne rrugë, ne afërsi të selisë së Partisë Demokratike

AKTUALITET

Qeveria shtrin modelin Kayo tek rezerva e naftës, biznes 300 milionë euro në vit pa tender

Prijanaj Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 14:04



Qeveria ka miratuar një projektligj, i cili i jep të drejtën një institucioni publik të prokurorë mbi 300 milionë euro pa tendera. Institucioni do të quhet Autoriteti për Rezervën e Sigurisë së karburanteve.

"Autoriteti, për qëllime të krijimit, depozitimit dhe administrimit të rezervave të sigurisë së naftës, mund të kryejë blerjen, shitjen dhe kontraktimin e shërbimeve të depozitimit të rezervave nëpërmjet procedurave të veçanta, të cilat nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, për aq kohë sa justifikohet nga natyra specifike dhe funksioni i rezervave të sigurisë, duke garantuar parimet e transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit," thuhet në projektligjin e miratuar një ditë më parë nga qeveria.

Sipas draftit, rezervat e sigurisë do të krijohen gradualisht derisa sasia e tyre të arrijë sa konsumi i dy muajve në nivel kombëtar. Sipas tabelave të publikuara në relacionin bashkëngjitur ligjit, për vitin 2025 rezerva e detyrueshme e karburanteve do të duhet të ishte 240 mijë tonë, e cila në vlerë përkthehet në gati 200 milionë euro.

Këto sasi do të blihen nga Autoriteti i Rezervës, jashtë rregullave të prokurimit publik. Por si do të financohen 200 milionë euro për krijimin e kësaj rezerve?

Tarifë që në fakt është taksë

Në një kohë kur çmimi i naftës në treg ka arritur nivele të papërballueshme dhe kur të gjithë presin që qeveria të ulë taksat, në Shqipëri do të ndodhë e kundërta. Qeveria do të vendosë një tarifë të re mbi naftën, e cila do të paguhet nga qytetarët në çmimin fundor të saj.

Masa e tarifës do të përcaktohet pas miratimit të ligjit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Edhe pse praktikisht kjo është një taksë e mirëfilltë, qeveria ka vendosur ta quajë tarifë, për të nxjerrë jashtë loje parlamentin dhe për ta miratuar barrën e re shtesë që do të bjerë mbi qytetarët thjesht dhe vetëm më VKM pa diskutime në Kuvend.

Sikur të mos mjaftonte fakti, që Shqipëria i ka taksat mbi naftën, të paktën 65 lekë për litër më shumë se vendet e tjera të rajonit, tani ky hendek do të rritet sërish.

Kosto marramendëse dhe pikëpyetje të mëdha

Por 200 milionë eurot shtesë që qytetarët shqiptarë do të paguajnë për të financuar blerjen e rezervës së sigurisë, janë vetëm njëri nga zërat e kostos. Fatura e këtij operacioni është shumë më e madhe se kaq, pasi do të përfshijë edhe infrastrukturën e nevojshme për ruajtjen e rezervës, por edhe kostot administrative si fuqia punëtore apo dhe transporti.

Në ligj qeveria thekson se do të kontraktojë depo me qira për të mbajtur sasinë e rezervës.

"Objektet depozituese të Operatorëve Ekonomikë, të kontraktuar për ruajtjen e rezervave të sigurisë të jone të pajisur me vërtetim teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike për depozitimin e naftës bruto dhe nënprodukteve e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi," thuhet në projektligj.

Ndonëse mbetet e paqartë nëse ekzistojnë kapacitete kaq të mëdha depozituese në Shqipëri, pikëpyetja e dytë lidhet me koston. Aktualisht kostoja për marrjen me qira e depozitave të karburanteve është minimalisht 10 euro për ton në muaj.

Kjo do të thotë se për të ruajtur 200 mijë tonë rezervë karburanti sa kërkon qeveria që këtë vit duhet minimumisht 2.0 milionë euro në muaj. Nëse ketyre u shtohen edhe kostot e transportit dhe fuqisë punëtore, faktura e mbajtjes së rezervës do të jetë dukshëm më e lartë se sa shifra 200 milionë euro. Por nuk mbaron as këtu.

Si do blejë dhe shesë Autoriteti naftë?

Karburantet kanë vetinë që skadojnë dhe rezerva e tyre duhet të rinovohet duke shitur sasitë ekzistuese dhe duke blerë sasi të reja. Kjo nënkupton se autoriteti shtetëror do të blejë dhe shesë naftë në treg për nevojat e rezervës.

Shqipëria ka një eksperiencë të ngjashme me energjinë elektrike, ku kompanitë shtetërore blejnë dhe shesin energji. Ajo që ndodh është se e blejnë shtrenjtë dhe e shesin lirë duke humbur para publike, të cilat u ngarkohen si humbje në kurriz qytetarëve.

Ky është një operacion marrëzie me kosto stratosferike, ndonëse qeveria thotë se krijimi i rezervës është kusht nga Bashkimi Europian. Megjithatë direktivat e BE-së nuk përcaktojnë formën e mbajtjes së rezervës. Ajo mund të jetë shtetërore, por mund të mbahet edhe nga kompanitë private, fizikisht në depot e tyre, në pikat e karburanteve, apo dhe në anijet e porositura.

Për më tepër, ky projektligj hedh dyshime se do të çojë para tek klientët e qeverisë. Në ligj thuhet se Autoriteti do të marrë depozita me qira nga privatët. Paralelisht ai mund ta delegojë këtë funksion direkt tek privatët.

Autoriteti për një periudhë të caktuar, mund të delegojë detyra që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë, me përjashtim të shitjes dhe blerjes të rezervave specifike, tek operatorët ekonomikë, në baze të një Marrëveshje që lidhet midis Autoritetit dhe operatorit ekonomik," thuhet në ligj.

Pra në mes të autoriteti dhe privatëve që kanë depot mund të hyjë një tjetër privat sekser, i cili merr me qira depot nga privatët dhe ja faturon qeverisë me shtrenjtë. Biznes për Ronët e qeverisë./Kapitali.al

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 17 Shtator13:53

[Sherri me thika ku u plagosën dy vëllezër, tre të arrestuar në Sarandë](#)

Një sherr me mjete prerëse ka përfunduar me dy të plagosur dhe tre të arrestuar mbrëmjen e së mërkurës, 16 shtato...

AKTUALITET 17 Shtator13:48

[Ende asnjë gjurmë për Alket Rizain në Greqi! Dyshohet se mund të ketë hyrë në Shqipëri](#)

Shqiptari Alket Rizai vazhdon të jetë ende i zhdukur dhe nuk është kthyer më në burgun e Domokos në Greqi, nga ku kishte ma...

AKTUALITET 17 Shtator13:32

[Grabitën me dhunë dy pika karburanti në Bulqizë, në kërkim dy autorët](#)

Dy pika karburanti janë vjedhur me dhunë gjatë mbrëmjes së djeshme në Bulqizë. Sipas raportimit të policisë, ngjarj...

AKTUALITET 17 Shtator13:18

[Botoxi kontrabandë/ Si u mbyll dosja për doktorin e VIP-ave, Skerdi Faria!](#)

Biznesmeni Dritan Gremi dhe shoqëria "Gremi Wellness" janë marrë të pandehur në kuadër të dosjes së botoks...

AKTUALITET 17 Shtator13:03

[Gjykata e Tiranës liron protestuesit e arrestuar pas tubimit të së hënës](#)

Gjykata e Tiranës ka vendosur lirimin e protestuesve të arrestuar pas protestës së zhvilluar të hënë në Tiranë. ...

AKTUALITET 17 Shtator12:56

[Kontrolle blic në burgun e Peqinit, gjendet celular në sendet personale të një të burgosuri](#)

Gjatë kontrolleve të ushtruara në kuadër të masave për garantimin e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të ve...

AKTUALITET 17 Shtator12:03

[‘Polici e krimit’/ Protestuesit heqin gardhin metalik, shtohen tensionet: Mos e mbroni Ramën](#)

Protestuesit "shkulin" gardhin metalik te Ministria e Brendshme. Qytetarët e vendosur të protestojnë përpara Kuvendit kanë...

AKTUALITET 17 Shtator11:59

[DEA amerikane ngre alarmin për mafien shqiptare/ Uruguaji: Po depërtojnë në vendin tonë](#)

DEA amerikane paralajmëroi për përparimin e mafias shqiptare në Amerikën Latine. Në Uruguai është zbuluar hyrja e shte...

AKTUALITET 17 Shtator11:43

[Tensione në protestën jashtë Kuvendit, qytetarët godasin me vezë efektivët e policisë](#)

Protesta e qytetarëve jashtë Parlamenti është përshkallëzuar, ku protestuesit kanë goditur me vezë efektivët e po...

AKTUALITET 17 Shtator11:40

[Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtari i trupit gjykues](#)

Shtyhet seanca gjyqësore ndaj ish-presidentit Ilir Meta dhe Monika Kryemadhit në Gjykatën e Posaçme (GJKKO), ndërsa seanca e radhës...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktime/ Prezantues...](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjyqësor në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafigas, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



E premte | ? 20:45 | Syri TV



E premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.